



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA, u skladu sa ovlašćenjima datim članom 64 stav 2 podstav 2.1 i 2.2 i članom 127 Zakona br. 08/L-228, o Opštim izborima u Republici Kosovo, na redovnom sastanku održanom 12.03.2024, donosi:

ODLUKA

O usvajanju Izbornog Pravilnika Br.12/2024 Glasanje, prebrojavanje na biračkom mestu i upravljanje biračkim mestom

- I. Usvaja se Izborni Pravilnik Br.12/2024 Glasanje, prebrojavanje na biračkom mestu i upravljanje biračkim mestom.
- II. Pravilnik kao u tački I, sastavni je deo ove odluke.
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Priština, 12.03.2024

Predsedavajući

Centralna izborna komisija

Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe 2.2, nenit 85, 86, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe nenit 127, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), nenit 20 dhe 29, paragrafi 2 i Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 12.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 12/2024

VOTIMI, NUMËRIMI NË VENDVOTIM DHE MENAXHIMI I VENDVOTIMIT

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton procesin e votimit, numërimit brenda Vendvotimit (VV), menaxhimin, sigurimin e VV, rolin e vëzhgueseve, librin e votimit, materialet e fushatës zgjedhore dhe materialet për informim të votuesve, procedurat para fillimit të votimit, të drejtën e votës, dokumentet e pranueshme të votimit, votimin rregullt, votimin me kusht, procesin e numërimit të rezultateve në VV dhe pranim-dorëzimin e materialit zgjedhor në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN).

Neni 2

Vendvotimi dhe Vendndodhja

1. VV vendosen duke filluar në katin përdhësë, në një vend të përshtatshëm për hyrje-dalje, për t'u mundësuar votuesve të krijojnë rresht dhe të qëndrojnë në të dhe kur është e mundur vendi për hyrje-dalje të jetë i rrafshët, ashtu që personat me nevoja të veçanta të mund të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të papenguar.
2. VV duhet të jetë mjaftueshëm i madh, që të sigurojë zhvillim të rregullt të votimit, duke vendosur të gjitha tavolinat e punës si janë definuar në këtë Rregullore dhe duke siguruar fshehtësinë e votimit, shikimin dhe kontrollin e lirë të kutisë së votimit dhe qasje të papenguar për vëzhguesit.

Neni 3

Përbërja dhe menaxhimi i VV

1. VV menaxhohet nga kryesuesi i VV, i cili është i obliguar që të sigurohet që në VV janë të pranishëm:
 - 1.1. Anëtarët e Këshillit të Vendvotimit (KVV);
 - 1.2. vëzhguesit e akredituar, por jo më shumë se një vëzhgues nga e njëjta organizatë;
 - 1.3. votuesit me të drejtë vote në atë VV, gjatë kohës së ushtrimit të drejtës së votës;
2. Kryesuesi, së bashku me anëtarët e KVV, sigurohet që të bëjë të gjitha përgatitjet paraprake të parapara në Rregulloren Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, për fillimin e procesit të votimit.
3. Kryesuesi i KVV është përgjegjës për të gjitha aktivitetet në VV, prej procesit të pranimit e derisa të bëhet dorëzimi i materialit te Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ).
4. Përrjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, pas evidentimit nga kryesuesi në VV, përkohësisht mund të jenë të pranishëm:
 - 4.1. Staf i KQZ;
 - 4.2. anëtarët e KKZ, të komunës përkatëse;
 - 4.3. vëzhguesit e akredituar të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare dhe mediave;
 - 4.4. policia, në rastet kur thirret nga KVV.

Neni 4

Materiali i informimit të votuesve dhe shenjat orientuese në VV dhe në QV

1. KQZ sigurohet që të përgatitë materialin për informim të votuesve në VV dhe në QV. Menaxheri i QV dhe KVV obligohet që të njëjtat t'i vendosin një ditë para ditës së zgjedhjeve në hapësira të QV dhe në VV.
2. Materiali për informim të votuesve përfshin:
 - 2.1. Listën e subjekteve politike, që janë të paraqitura në fletëvotim;
 - 2.2. listën e kandidatëve të secilit subjekt politik, siç janë të paraqitur në broshurën e kandidatëve për zgjedhjet përkatëse;
 - 2.3. të drejtat e votuesit dhe procedurën e votimit;
3. KQZ sigurohet që të përgatitë shenjat orientuese për informim të votuesve në VV dhe në QV, të cilat janë të dukshme. Menaxheri i QV dhe KVV obligohet që të njëjtat t'i vendosin në hapësirat e dukshme të QV dhe në VV.
4. Shenjat orientuese për informim të votuesve në QV, përfshijnë, por nuk kufizohen:
 - 4.1. Emrin dhe kodin e QV;

- 4.2. shenjat për të drejtuar votuesin në VV;
 - 4.3. kodin dhe shkronjat e para të mbiemrave nga LV të VV përkatës;
 - 4.4. poster me listën e ndalesave, që përfshijnë: ndalimin e armëmbajtjes, fotografimin e votës, votimin familjar.
5. Shenjat orientuese për informim të votuesve në VV, përfshijnë, por nuk kufizohen:
- 5.1. Kodin dhe shkronjat e para të mbiemrave nga LV të VV përkatës;
 - 5.2. shenjat për të drejtuar votuesin gjatë procesit të votimit;
 - 5.3. poster me listën e ndalesave që përfshijnë: ndalimin e armëmbajtjes, fotografimin e votës, votimin familjar.

Neni 5

Libri i Votimit

1. Çdo VV ka librin e votimit, në të cilin shënohen të gjitha ngjarjet në lidhje me mbarëvajtjen e procesit të votimit dhe numërimin në VV gjatë ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë të dhënat statistikore të pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje, sipas intervaleve kohore të përcaktuara nga KQZ.
2. Vetëm kryesuesi i KVV, anëtarët e KVV dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm, lejohen të bëjnë shënime në librin e votimit.
3. Nëse votuesi ka ankesë në lidhje me ndonjë aktivitet brenda VV, ai/ajo mund të kërkojë nga Kryesuesi i KVV, regjistrimin e ankesës së tij/saj në librin e votimi dhe udhëzohet për të marrë formularin e ankesës të tryeza ndihmëse e QV.

Neni 6

Mbarëvajtja në VV

1. Kryesuesi i KVV, me ndihmën e të gjithë anëtarëve, duhet të sigurojë mbarëvajtje të procesit të votimit brenda VV.
2. Në rast të pengimit të procesit zgjedhor, Kryesuesi i KVV mund të udhëzojë një anëtar të KVV, vëzhgues apo votues, që të lirojë hapësirën e VV.
3. Në rast se cenohet siguria dhe mbarëvajtja e procesit zgjedhor brenda VV, kryesuesi i KVV kërkon ndihmë të menjëhershme nga policia, informon KKZ dhe mund të vendosë ta pezullojë përkohësisht procesin në VV, derisa të rivendoset rendi. Gjatë kohës së pezullimit, në VV qëndrojnë anëtarët e KVV dhe vëzhguesit. Kryesuesi dhe anëtarët kujdesen për materialet e ndjeshme, ndërsa kryesuesi shënon ngjarjen në librin e votimit, duke përfshirë kohën gjatë të cilës është pezulluar votimi.

4. KVV është përgjegjëse për të evidentuar në librin e votimit dhe për të raportuar menjëherë organet përkatëse të rendit, për çdo material të fushatës zgjedhore të subjekteve politike të paraqitur në VV.
5. Asnjë informatë e fushatës zgjedhore të subjekteve politike nuk lejohet të transmetohet nga asnjë pajisje komunikimi në VV apo QV dhe as në distancë të dëgjueshme brenda hapësirave të QV. Një veprim i tillë raportohet nga KVV dhe nga menaxheri i QV në PZAP dhe KKZ, menjëherë pasi që shkelja të jetë bërë.

Neni 7

Përgatitja teknike e VV para ditës së zgjedhjeve

1. Përgatitja teknike dhe rregullimi i VV bëhet një ditë para ditës së zgjedhjeve.
2. Një ditë para ditës së zgjedhjeve, KVV pranon dhe verifikon materialin zgjedhor jo të ndjeshëm dhe rregullon hapësirën brenda VV.
 - 2.1. Mënyra e organizimit të VV duhet të mundësojë qarkullim të lirshëm të votuesve dhe të ofrojë transparencë;
 - 2.2. ulëset dhe tavolinat rregullohen në atë mënyrë që, anëtarët e KVV dhe vëzhguesit e zgjedhjeve të mund ta shikojnë tërë procesin e votimit dhe t'i shohin qartë kutitë e votimit gjatë gjithë kohës;
 - 2.3. kabinat e votimit vendosen në dy kënde të hapësirës, në atë mënyrë që të sigurohet që votuesi të mund të votojë në fshehtësi.

Neni 8

Aktivitetet e KVV para fillimit të votimit

1. Deri në orën 06:00, në ditën e zgjedhjeve, në hapësirat e QKN, kryesuesi dhe njëri nga anëtarët e KVV, bëjnë pranim-dorëzimin e materialit të ndjeshëm zgjedhor nga KKZ, shtojca VII - Formulari i pranim-dorëzimit të materialit të ndjeshëm nga QKN në KVV.
2. Në rast se gjatë kohës së përcaktuar për pranim-dorëzimin e materialit të ndjeshëm zgjedhor nuk është prezent kryesuesi i KVV, KKZ ndërmer veprime të menjëhershme për të kontaktuar kryesuesin apo për ta zëvendësuar atë sipas procedurave të parapara në Rregulloren Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve.
3. Transporti i materialit të ndjeshëm zgjedhor nga QKN në VV, bëhet sipas procedurës për transportin e materialit të ndjeshëm dhe jo të ndjeshëm zgjedhor.
4. Kryesuesi dhe KVV sigurohet që materiali jo i ndjeshëm, materiali informues dhe orientues, është i vendosur në mënyrë të duhur dhe të dukshme në VV.
5. Kryesuesi, në praninë e anëtarëve të KVV, verifikon dhe evidenton në librin e votimit

materialin e ndjeshëm zgjedhor.

6. Kryesuesi i KVV, sigurohet që kamerat regjistruese dhe materialine ndjeshëm zgjedhor ta shpërndaj dhe të funksionalizoj ato sipas procedurave të parapara në Rregulloren Nr.11/2024, Këshillat e Vendvotimit dhe Procedurat e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim.
7. Kryesuesi konstaton prezencën e anëtarëve të KVV, të vëzhguesve dhe të njëjtën e evidenton në librin e votimit. Kryesuesi i KVV informon KKZ për cilindo anëtar të KVV që mungon dhe kërkon zëvendësim.
8. Kryesuesi verifikon dhe shënon numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pranura në shtojcën I - FRS –Formularin e Rezultateve të Subjekteve;
9. Njëri prej anëtarëve të KVV ekspozon kutinë e zbrazët të votimit në prani të anëtarëve të KVV dhe vëzhguesve, pastaj kutinë e votimit e mbyllë me shiritat e sigurisë të komunës përkatëse, ndërsa kryesuesi shënon numrat serik të shiritave mbyllës të kutisë së votimit në FRS.
10. Për çdo nivel apo lloj të zgjedhjeve duhet të ketë kuti të veçantë të votimit, në të cilën shënohet qartë lloji i zgjedhjeve dhe numri i VV, shtojca Nr.VIII – Etiketa e kodit të vendvotimit.

Neni 9

Orari i votimit

1. VV hapen në orën 07:00 dhe të mbyllen në orën 19:00. Kryesuesi i KVV shënon kohën e hapjes dhe mbylljes së VV në librin e votimit.
2. Nëse VV hapet me vonesë, kryesuesi i KVV menjëherë e njofton KKZ dhe shënon arsyen e vonesës në librin e votimit.
3. Askush nuk mund të votojë pas kohës së mbylljes së QV, përveç votuesve të cilët presin në radhë para VV, në kohën e mbylljes.

Neni 10

E drejta e votës dhe fshehtësia e votës

1. Votuesi e ushtron të drejtën për të votuar, pa u penguar nga askush.
2. Asnjë person nuk lejohet të votojë në emër të një personi tjetër, apo më shumë se një herë, për të njëjtat zgjedhje.
3. Votuesi plotëson fletëvotimin e vet në fshehtësi, në kabinën e votimit dhe vetëm atij i lejohet të qëndrojë në kabinën e votimit gjatë votimit.

4. Votuesi mund të kërkojë sqarim për procedurën e votimit, nga dhënësi i fletëvotimit.
5. Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, kur aftësia e tij e kufizuar dëshmohet përmes dokumenteve përkatëse, mund të ndihmohet nga një person tjetër (asistuesi) nga e njëjta QV, i zgjedhur nga votuesi, duke ndjekur procedurën e mëposhtme:
 - 5.1. Personi që asiston duhet të jetë i moshës 18 vjeç dhe të ketë një nga dokumentet e identifikimit të Republikës së Kosovës, si në nenin 11 të kësaj Rregullore;
 - 5.2. asistuesi e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV ose vëzhgues i akredituar;
 - 5.3. në rastin kur personi i asistuar nuk është në gjendje fizike të nënshkruaj atëherë asistuesi shkruan në LV “PËR: emrin dhe mbiemrin e tij”, në hapsirën e votuesit që është asistuar;
 - 5.4. kryesuesi i KVV shënon në Librin e Votimit numrin rendor, kohën, të dhënat personale të votuesit dhe të asistuesit si dhe arsyen e saktë të votimit me asistencë. Numri i rastit në Librin e Votimit shënohet në hapësirën e votuesit në LV;
 - 5.5. asistuesi mund ta ndihmojë në votim personin me aftësi të kufizuar, duke ia mbajtur dorën dhe mundësuar që votuesi të shënojë vetë fletëvotimin. Në rast se votuesi nuk mund ta hedhë fletëvotimin në kuti, atëherë asistuesi e ndihmon këtë proces.
6. Nëse votuesi është i verbër, udhëzohet që të votojë në mënyrë të pavarur, përmes shabllonit me alfabetin e brail-it, që gjendet në tavolinën ndihmëse në QV.
 - 6.1. Në rast se votuesi i verbër nuk di të përdor alfabetin e brail-it, atëherë aplikohen procedurat sipas paragrafit 5 të këtij neni.
7. Përjashtimisht paragrafit 5 dhe 6 të këtij neni, të gjitha rasteve tjera të asistencës fizike, nuk u lejohet ndihma në nënshkrim në LV e as qëndrimi në kabinë të votimit gjatë procesit të votimit.
8. Kryesuesi dhe anëtarët e KVV, sigurohen që të parandalojnë keqpërdorimin apo tentimin për keqpërdorim të së drejtës për votim me asistencë. Rastet e tilla obligohen t’i raportojnë në organet e rendit dhe t’i evidentojnë në librin e votimit.
9. Anëtarët e KVV nuk lejohet në asnjë mënyrë të ndikojnë në vendimin e votuesit.
10. Anëtarët e KVV sigurojnë që votuesi nuk shqetësohet nga askush gjatë votimit dhe që fshehtësia e votimit dhe e votës është siguruar plotësisht.

Neni 11

Dokumentet e pranueshme të identifikimit

1. Secili votues identifikohet nga Zyrtari i identifikimit në VV, përmes njërës nga dokumentet e vlefshme të identifikimit, të lëshuara nga Republika e Kosovës, si në vijim:
 - 1.1. Letërnjoftimi;
 - 1.2. pasaporta;
 - 1.3. leja e vozitjes.

Neni 12

Votimi i rregullt

1. Çdo votues, para se të hyjë në VV, kontrollohet nga zyrtari kontrollues i rreshtit, nëse ka njollë të ngjyrës matrikuluese në gishtërinjtë.
2. Votuesit në gishtin e të cilit gjendet njolla e ngjyrës matrikuluese, nuk i lejohet të votojë.
3. Pas hyrjes në VV, votuesi udhëzohet nga kontrolluesi i rreshtit që të vazhdojë tek zyrtari i identifikimit, i cili kontrollon nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LV:
 - 3.1. Nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LV, pa një shenjë ose shënim, votuesi duhet të udhëzohet që të nënshkruajë në LV, pranë emrit të tij/saj;
 - 3.2. nëse emri dhe mbiemri i votuesit nuk figuron në LV, votuesi udhëzohet që ta vizitojë tavolinën ndihmëse të QV, për të mësuar se në cilin QV dhe VV është caktuar të votojë;
 - 3.3. nëse zyrtari i identifikimit vëren se votuesi gabimisht nënshkruhet në LV, në hapsirën e një votuesi tjetër, menjëherë e njofton kryesuesin dhe e udhëzon votuesin të nënshkruajë në hapësirën e tij në LV dhe anulon nënshkrimin e gabueshëm, duke shënuar anash LV dhe numrin e rastit në librin e votimit. Rasti evidentohet në librin e votimit, duke shënuar kohën e saktë dhe të dhënat e votuesit;
 - 3.4. votuesi, në hapsirën e të cilit është evidentuar gabimi i nënshkruesit paraprak, njoftohet për rastin e ndodhur dhe udhëzohet të nënshkruajë në hapsirën e tij;
 - 3.5. pasi votuesi nënshkruhet në LV, ai udhëzohet nga zyrtari i identifikimit që të vazhdojë tek dhënësi i fletëvotimit;
 - 3.6. votuesi i cili refuzon që të nënshkruhet në LV, nuk do t'i jepet fletëvotimi dhe kryesuesi i VV sigurohet që i njëjti të largohet nga VV dhe rasti evidentohet në librin e votimit.
4. Dhënësi i fletëvotimit sqaron mënyrën e votimit, nëse kërkohet nga votuesi, ndan me kujdes fletëvotimin nga numrat amë dhe e vulos në hapësirën e caktuar. Pas ndarjes së fletëvotimit, dhënësi i fletëvotimit bën me ngjyrë matrikuluese në gishtin e madh të dorës së djathtë të të votuesit, përjashtimisht rastet specifike. Pas vendosjes së ngjyrës matrikuluese, votuesit i jepet fletëvotimi dhe udhëzohet të shkojë te njëra nga kabinetat e votimit, për të votuar në fshehtësi.

5. Votuesi i cili refuzon që të shënjohe me ngjyrë matrikuluese, nuk do t'i jepet fletëvotimi dhe kryesuesi i VV sigurohet që i njëjti të largohet nga VV dhe rasti evidentohet në librin e votimit.
6. KVV sigurohet që në secilën kabinë të votimit gjendet nga një broshurë me emrat e subjekteve dhe kandidatëve për zgjedhje përkatëse. Votuesi mund ta informojë kryesuesin e KVV nëse: mungon broshura, nëse në faqet e saj ka shënime apo ato janë të grisura. Kryesuesi duhet të sigurojë broshurën e re nga ato rezervë.
7. Nëse votuesi e ka dëmtuar fletëvotimin e vet, ai/ajo mund ta dorëzojë fletëvotimin e dëmtuar tek kryesuesi i KVV, i cili e udhëzon tek dhënësi i fletëvotimit, për të marrë fletëvotimin e ri të vulosur. Kryesuesi e tregon para KVV dhe vëzhguesve fletëvotimin e dëmtuar, shkruan në pjesën e prapme të fletëvotimit të dëmtuar fjalën "I DËMTUAR" dhe e vendosë në zarfën për fletëvotime të dëmtuara. Rasti evidentohet në librin e votimit, duke shënuar kohën dhe numrin serik të amës së fletëvotimit.
8. Pas votimit, votuesi duhet ta palosë dhe vendosë fletëvotimin në kutinë e votimit, ashtu që të mund të shihet vula në fletëvotim nga anëtarët e KVV dhe vëzhguesit.
9. Mbikëqyrësi i kutisë së votimit, duhet të sigurojë që votuesit e vendosin vetëm fletëvotimin e duhur në kutinë përkatëse të votimit.
10. Mbikëqyrësi i kutisë së votimit, nuk duhet ta lejojë asnjë votues që të largohet nga VV pa e vendosur fletëvotimin në kutinë përkatëse të votimit. Refuzimi i votuesit që të veprojë në përputhje me këtë kërkesë, raportohet menjëherë te kryesuesi i KVV dhe organet e rendit. Rasti evidentohet në librin e votimit, duke shënuar kohën dhe të dhënat personale të personit.

Neni 13

Votimi me kusht

1. KQZ-ja përcakton numrin e QV me kusht. KQZ mund të mos organizojë votimin me kusht, nëse vlerëson se kanë pushuar arsyet e organizimit të tij.
2. Votimi me kusht nuk aplikohet për votuesit që votojnë në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës.
3. Votuesi në Kosovë, emri dhe mbiemri i të cilit gjendet në LV, i cili për arsye objektive nuk mund të votojë në vendvotimin e tij/saj i lejohe të votojë në QV me kusht në cilëndo komunë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.
4. Në zgjedhjet lokale, votuesit i lejohe të votojë me kusht në komunën në të cilën ai figuron në LV të komunës përkatëse.
5. Zyrtari i identifikimit, skanon kodin e Zarfës të Votimit me Kusht – ZVK, shënon numrin personal, emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes të votuesit dhe skanon dokumentin e identifikimit, në platformën elektronike të KQZ.

6. Zyrtari i të dhënave statistikore, asiston zyrtarin e identifikimit, duke shënuar emrin, mbiemrin e votuesit dhe udhëzon votuesin që të nënshkruaj në Listën e Votuesëve me Kusht – LVK. Pas nënshkrimit, votuesi udhëzohet të kalojë te dhënësi i fletëvotimit.
7. Nëse votuesi refuzon të nënshkruajë në LVK, nuk do t'i jepet fletëvotimi dhe kryesuesi i VV sigurohet që i njëjti të largohet nga VV dhe rasti evidentohet në librin e votimit.
8. Dhënësi i fletëvotimit i'a dorëzon fletëvotimin votuesit, ndërsa ZVK i'a dorëzon kryesuesit të VV.
9. Pas votimit, kryesuesi i KVV i'a dorëzon ZVK votuesit, i cili në prani të anëtarëve të KVV dhe vëzhguesve, e vendos fletëvotimin në ZVK e mbyllë atë dhe e vendosë në kutinë e votimit.

Neni 14

Mbyllja e QV dhe VV

1. QV mbyllen në orën 19:00. Çdo person që gjendet në radhë brenda QV në momentin e mbylljes, i lejohet të votojë. Menaxheri i QV dhe kryesuesi i VV, sigurojnë që të gjithë ata që janë në radhë brenda QV, hyjnë në VV. Personi që vjen pas mbylljes së QV, nuk mund të votojë.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, KQZ me vendim të 2/3 të votave, në rast shfaqjeje të një force madhore, mund të vendosë për zgjatjen e orarit të votimit për një apo më shumë QV pas njoftimit nga KKZ.
3. Pasi të votojë personi i fundit në radhë, kryesuesi i KVV e mbyllë VV, e mbyllë kapakun e kutisë së votimit me shiritin e sigurisë, në atë mënyrë që kjo të mund të shihet nga vëzhguesit, ndërsa në librin e votimit e shënon kohën e saktë të mbylljes dhe numrin e shiritit të sigurisë, i cili shënohet edhe në FRS.

Neni 15

Procesi i numërimit në VV e rregullta

1. Procedurat e numërimit të fletëvotimeve udhëhiqen nga këto parime:
 - 1.1. Saktësia;
 - 1.2. transparenca;
 - 1.3. efikasiteti;
 - 1.4. integriteti;
 - 1.5. mbrojtja e sigurisë së votës.
2. Në VV numërohen vetëm votat për subjektet politike.
3. Pasi të mbyllet VV, kryesuesi i KVV shënon në librin e votimit: emrat, numrat personal

- dhe numrat e akreditimit të të gjithë vëzhguesve të pranishëm dhe i informon që, nëse largohen nga VV para përfundimit të numërimit, nuk lejohen të kthehen në VV.
4. Gjatë procesit të numërimit, kryesuesi i KVV nuk lejon askë të hyjë brenda VV, përveç anëtarëve të KQZ dhe KKZ dhe zyrtarët e autorizuar nga KQZ dhe KKZ. Të njëjtit kryesuesi i KVV i evidenton në librin e votimit.
 5. Para fillimit të numërimit, kryesuesi udhëzon anëtarët e KVV, që të:
 - 5.1. Vendosin vulën dhe ngjyrën matrikuluese në një thes plastik, që mbyllet me shiritin e sigurisë, numrat e të cilit shënohen në librin e votimit;
 - 5.2. largojnë lapsat që janë përdorur gjatë procesit të votimit dhe materialet tjera që nuk nevojiten për numërim, të cilat vendosen në thes plastik, që mbyllet me shiritin e sigurisë, numrat e të cilit shënohen në librin e votimit;
 - 5.3. organizojnë hapësirën e numërimit në atë mënyrë që, mundëson numërimin efikas për anëtarët e KVV dhe në mënyrë transparente për vëzhguesit, të përcaktuar sipas procedurës;
 - 5.4. shpërndajnë lapsat dhe materiale tjera të dedikuara për numërim, si: Formulari i Rezultateve të Subjekteve – FRS, notesin dhe materiale tjera administrative, të përcaktuara sipas procedurës.
 6. Pas përgatitjeve teknike për numërim, kryesuesi sigurohet që në rast se në VV ka më shumë se një kuti të votimit, kutia e radhës të hapet pas përfundimit të procesit të numërimit dhe mbyllet të kutisë paraprake.
 7. Kryesuesi ndan detyrat për anëtarët e KVV, si në vijim:
 - 7.1. Dhënësi i fletëvotimit, i ndihmuar nga një anëtar i KVV, llogaritë numrin e nënshkrimeve në LV, ndërsa kryesuesi shkruan numrin e tyre në FRS. Gjatë këtij procesi, asnjë veprim tjetër nuk mund të zhvillohet në të njëjtën kohë.
 - 7.2. zyrtari i identifikimit, i ndihmuar nga një anëtar i KVV, evidenton dhe numëron:
 - 7.2.1. Fletëvotimet e mbetura të papërdorura;
 - 7.2.2. numrat amë të fletëvotimeve të përdorura;
 - 7.2.3. fletëvotimet e dëmtuara dhe i vendosin ato prapë në zarfin e caktuar për fletëvotime të dëmtuara.
 - 7.3. kryesuesi i KVV sigurohet që rezultatet e pranuar sipas nënpargrafit 7.2. të këtij neni, t'i shënojë në FRS.
 8. Para hapjes së kutisë së votimit, kryesuesi i KVV verifikon numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit, nëse këta numra janë të njëjtë me numrat e regjistruar në FRS, si dhe ndan me një anë fletëvotimet e papërdorura, zarfet me fletëvotime të dëmtuara dhe LV.
 9. Gjatë hapjes së kutisë, kryesuesi i KVV cakton njërin prej anëtarëve të KVV që të heqë

shiritat mbyllës dhe hapë kutinë e votimit. Shiritat vendosen në thesin përkatës, i cili në fund të procesit mbyllet me shirit të sigurisë.

10. Kryesuesi cakton një anëtar të KVV të hap kutinë e votimit dhe të nxjerrë fletëvotimet, duke u siguruar që asnjë fletëvotim të mos mbetet brenda asaj kutie të votimit.
11. Kryesuesi dhe anëtarët e KVV numërojnë dhe klasifikojnë të gjitha fletëvotimet, sipas kësaj renditje:
 - 11.1. Shpalosin fletëvotimet, duke i kthyer mbrapsht, verifikojnë nëse të njëjtat janë të vulosura dhe i takojnë atij VV, i klasifikojnë të vulosurat dhe të pa vulosurat;
 - 11.1.1. Fletëvotimet e pavulosura ndahen dhe evidentohen si vota të pavlefshme.
 - 11.2. kthejnë fletvotimet e vulosura mbarë dhe klasifikojnë fletvotimet në të vlefshme dhe të pavlefshme;
 - 11.3. ndajnë fletëvotimet e vlefshme sipas subjekteve politike;
 - 11.4. pas ndarjes së fletëvotimeve, numërohen votat për secilin subjekt politik veç e veç dhe ndahen sipas dengjeve (me nga 50 fletëvotime);
 - 11.5. fletëvotimet rinumërohen, për të vërtetuar nëse ka çfarëdo mospërputhje midis numrit të fletëvotimeve në kuti dhe numrit të nënshkrimeve në LV;
 - 11.6. nëse edhe pas rinumërimit konstatohen mospërputhje, kutia mbyllet, sinjalizohet dhe përcillet në QKN.
12. Përgjashtimisht paragrafit 11 të këtij neni, në rast kur ka më shumë se një palë zgjedhje dhe ka mospërputhje në kutinë e hapur apo gjendet fletëvotim nga zgjedhjet tjera, atëherë rezultatet evidentohen në fletën e punës, derisa të verifikohen kutia apo kutitë tjera të atij VV. Rasti evidentohet në librin e votimit, fletëvotimet numërohen dhe i bashkohen fletëvotimeve të zgjedhjeve përkatëse dhe rezultati shënohet në FRS përkatëse.

Neni 16

Vlefshmëria e fletëvotimit dhe votës

1. Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse:
 - 1.1. Është i vulosur;
 - 1.2. ka numrin serik të VV përkatës.
2. Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit:
 - 2.1. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik;
 - 2.2. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur:

- 2.2.1. Kur votohet më shumë se një subjekt politik;
 - 2.2.2. kur nuk votohet asnjë subjekt politik;
 - 2.2.3. kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik;
 - 2.2.4. kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.
3. Në zgjedhjet për Kuvendin e Komunës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik.
 - 3.1. Në zgjedhjet për Kuvendin e Komunës, votat konsiderohen të pavlefshme në rastet kur:
 - 3.1.1. Votohet më shumë se një subjekt politik;
 - 3.1.2. nuk votohet asnjë subjekt politik;
 - 3.1.3. votohet vetëm kandidati dhe jo subjekti politik;
 - 3.1.4. qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.
4. Vota për kandidatët nga zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendin e Komunës numërohen në QKN.
5. Për zgjedhjet për Kryetar të Komunës, votë e vlefshme konsiderohet atëherë kur votuesi e ka shënuar vetëm një kandidat në fletëvotim.
 - 5.1. Në zgjedhjet për Kryetar të Komunës, vota konsiderohet e pavlefshme në rast se:
 - 5.1.1. Votohet më shumë se një kandidat për kryetar;
 - 5.1.2. nuk votohet asnjë kandidat;
 - 5.1.3. qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.
6. Nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkritazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit.
7. Anëtarët e tjerë të KVV dhe vëzhguesit e pranishëm në VV, kanë të drejtë të mbajnë shënime për numërimin dhe në rast të gabimeve gjatë numërimit, të tërheqin vërejtjen.

Neni 17

Paraqitja e rezultateve në formularë

1. Për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës votat e numëruara për subjektet politike, shënohen nga kryesuesi i KVV në FRS.

2. Për zgjedhjet për Kuvendin Komunal votat e numëruara për subjektet politike, shënohen nga kryesuesi i KVV në Shtojcën II – Formularin e Rezultateve të Subjekteve për Kuvendin Komunal (FRSKK).
3. Për zgjedhjet për Kryetar Komune votat e numëruara shënohen nga kryesuesi i KVV në Shtojcën III – Formulari i rezultateve për zgjedhjet për Kryetar Komune (FRKK) ;
4. Pas përfundimit të numërimit dhe evidentimit të të gjitha fletëvotimeve dhe plotësimit të formularëve përkatës, paketimi i materialeve dhe mbyllja e kutive bëhet sipas procedurave të miratuara nga KQZ.
5. Anëtarët e KVV janë përgjegjës për saktësinë e rezultateve si dhe për plotësimin e saktë të shënimeve në formularët përkatës.

Neni 18

Numërimi i zarfeve, nënshkrimeve të votimit me kusht dhe regjistrimi i tyre në formularin e të dhënave

1. Pas mbylljes së VV me kusht, KVV numëron nënshkrimet në LVK dhe në regjistrin elektronik të votuesve.
 - 1.1. Në rast të mospërputhjes, kryesuesi i VV me Kusht evidenton këtë në Shtojcën VI – FVK – Formulari i Votimit me Kusht dhe në librin e votimit.
2. Pas numërimit të nënshkrimit KVV zbaton procedurat për hapjen e kutisë sipas nenit 15 të kësaj Rregullore, duke iu përshtatur numërimit të Vendvotimit me Kusht. Detajet e këtij procesi parashihen me Procedurën për Votim dhe Numërim në Vendvotim.
3. Kryesuesi cakton një anëtar të KVV të hap kutinë e votimit dhe të nxjerrë zarfet e fletëvotimit me kusht (ZFK) , duke u siguruar që asnjë ZFK të mos mbetet brenda asaj kutie të votimit.
4. Kryesuesi cakton dy anëtarë të KVVK-së për numërimin e ZFK-ve. Kryesuesi sigurohet që numërimi të bëhet dy herë.
5. Plotëson Formularin e Votimit me Kusht (FVK). Në rast të mospërputhjes së nënshkrimeve në LVK dhe numërimit të ZFK, Kryesuesi evidenton këtë në FVK dhe në librin e votimit.
6. Pas përfundimit të numërimit dhe evidentimit:
 - 6.1. Zarfet e numëruara i vendosë në kuti;
 - 6.2. mbyllë kutinë me shirita të sigurisë dhe evidenton, sipas procedurave të parapara me këtë Rregullore.

Neni 19

Procedurat pas numërimit të fletëvotimeve

1. Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve, kryesuesi i KVV:
 - 1.1. Lejon vëzhguesit e akredituar të pranishëm të marrin informata nga FRS apo FVK, nëse e kërkojnë një gjë të tillë;
 - 1.2. publikon kopjen e FRS apo FVK në hyrje të QV;
 - 1.3. liron anëtarët e KVV dhe i njofton se mund të kontaktohen nga KKZ.
2. Në pajtim me udhëzimet e KKZ, kryesuesi i KVV dorëzon materialin zgjedhor në QKN nën përcjelljen e policisë. Kryesuesin mund ta shoqërojë një apo më shumë anëtarë të KVV.

Neni 20

Votimi dhe numërimi në VV për raundin e dytë të zgjedhjeve

Procedura e votimit dhe numërimit në VV, për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar Komune, rregullohen në përputhje me këtë Rregullore, përjashtimisht paragrafit 4 të nenit 12 të kësaj Rregullore, ngjyra matrikuluese do të vendoset në gishtin e madh të dorës së majtë.

Neni 21

Procedurat pas pranimit të materialit nga KVV në QKN

Pranimi i materialit zgjedhor nga KVV në QKN si dhe procedurat e numërimit, paraqitja e të dhënave në Formularët e Rezultateve, bëhen në pajtim me Rregulloren për QKN.

Neni 22

Ankesat

1. Ankesat përkritazi me procesin e votimit dhe numërimit në VV, duhet të dorëzohen në PZAP, brenda 48 orëve nga mbyllja e VV.
2. Anëtarë i KKV ka të drejtë të shprehë vërejtjet apo komentet e tij për procesin e votimit, numërimit dhe të rezultateve, sipas nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 11/2024, për KVV.

Neni 23

Aktet dhe procedurat për zbatimin e kësaj Rregullore

1. KQZ, për zbatimin e kësaj Rregullore miraton:
 - 1.1. Procedurën për votim dhe numërim në VV dhe për Votim për Persona me Nevoja të Veçanta (VPNV), për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhjet lokale;
 - 1.2. pakon informuese për vëzhgues.

Neni 24

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr.12/2023 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë:
 - 2.1. Shtojca I – FRS –Formulari i Rezultateve të Subjekteve;
 - 2.2. shtojca II – FRSKK – Formularin e Rezultateve të Subjekteve për Kuvendin Komunal;
 - 2.3. shtojca III – FRKK – Formulari i rezultateve për zgjedhjet për Kryetar Komune;
 - 2.4. shtojca IV – FRK – Formularin e Rezultateve të Kandidatëve;
 - 2.5. shtojca V – FRKK – Zgjedhjet për Kryetar Komune – Raundi i Dytë;
 - 2.6. shtojca VI – FVK – Formularin e Votimit me Kusht;
 - 2.7. shtojca VII – Formulari i pranim-dorëzimit të materialit të ndjeshëm nga QKN në KVV;
 - 2.8. shtojca VIII - Etiketa e kodit të vendvotimit.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Rađonqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA, u skladu sa ovlaštenjima datim članom 64 stav 2 podstav 2.1 i 2.2 i članom 127 Zakona br. 08/L-228, o Opštim izborima u Republici Kosovo, na redovnom sastanku održanom 12.03.2024, donosi:

ODLUKA

O usvajanju Izbornog Pravilnika Br.13/2024 Izborni rezultati

- I. Usvaja se Izborni Pravilnik Br.13/2024 Izborni rezultati.
- II. Pravilnik kao u tački I, sastavni je deo ove odluke.
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Priština, 12.03.2024

Predsedavajući

Centralna izborna komisija


Kreshnik Radoniqi
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Priştinë
Priština
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1. dhe 2.2 dhe nenit 127 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), nenit 20 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 12.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR.13/2024

REZULTATET ZGJEDHORE

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton veprimet për procesin e raportimit dhe publikimit të rezultateve dhe statistikave preliminare, progresive, përfundimtare dhe certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Neni 2

Raportimi preliminar i rezultateve të zgjedhjeve

1. KQZ gjatë ditës së zgjedhjeve, grumbullon dhe publikon të dhënat për rezultatet dhe statistikën, të përmbledhura nga secili Komision Komunal i Zgjedhjeve (KKZ), brenda komunës përkatëse.
2. Raportimi preliminar përfshinë:
 - 2.1. Publikimin e statistikave të daljes së votuesve gjatë ditës së zgjedhjeve;
 - 2.2. publikimin e rezultateve për subjektet politike nga vendvotimet;
 - 2.3. publikimin e rezultateve të kandidatëve të subjekteve politike nga Qendra Komunale e Numërimit (QKN) dhe përditësimet tjera.
3. KQZ, përmes stafit të angazhuar për raportim, mbledhë të dhënat përmes platformës elektronike nga të gjitha vendvotimet (VV), për pjesëmarrjen në zgjedhje dhe rezultatet preliminare të subjekteve politike, të shënuara në Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike (FRS).

4. Rezultatet preliminare në ditën e zgjedhjeve, përfshijnë vetëm votat e subjekteve politike nga VV e rregullta, pa përfshirë votat nga zarfet e fletëvotimeve me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta dhe votat jashtë Kosovës.

Neni 3

Përgatitjet paraprake

1. KQZ bën përgatitjen e udhëzuesve dhe formave për raportim për KKZ në lidhje me raportimin, sipas paragrafit 2 të nenit 2 të kësaj Rregullore.
2. KQZ, angazhon staf për raportimin e rezultateve në të gjitha Qendrat e Votimit (QV).
3. Stafi për raportim trajnohet dhe pajiset me teknologji informative (TI), me udhëzuesin për raportim dhe nënshkruajnë Kodin e Sjelljes.
4. Më qëllim të mbarëvajtjes së procesit të raportimit në ditën e zgjedhjeve, sipas udhëzimeve, stafi për raportim kryen simulime të procesit të raportimit. Simulimi duhet të përfshijë futjen e përnjëhershme të të dhënave, në masë jo më pak se 60% të QV.

Neni 4

Publikimi i statistikave të daljes së votuesve gjatë ditës së zgjedhjeve

1. KQZ publikon në ueb faqe statistikave të pjesëmarrjes në zgjedhje për këto intervale kohore: 09:00, 11:00, 13:00, 15:00, 17:00, 19:00, përveç në rastet kur vendoset ndryshe nga KQZ.
2. Në publikimet e orës 13:00 dhe 19:00 përfshihen statistikave gjinore dhe të grupmoshave.
3. Raportimi i pjesëmarrjes në zgjedhje, varësisht nga lloji i zgjedhjeve, përfshinë të dhëna për pjesëmarrjen në zgjedhje në nivel vendi, komune, QV dhe VV.
4. Informatat për pjesëmarrje në zgjedhje përfshijnë të dhënat si vijon:
 - 4.1. Emri i komunës, QV dhe numrin (kodin) e VV;
 - 4.2. numrin e votuesve në listën votuese;
 - 4.3. numri i votuesve që kanë votuar;
 - 4.4. numri i përgjithshëm i vendvotimeve;
 - 4.5. numri i VV të procesuara, nga të cilat janë dërguar të dhënat;
 - 4.6. pjesëmarrja në zgjedhje, shprehur në përqindje në raport me numrin e përgjithshëm të votuesve të procesuar.

Neni 5

Publikimi i rezultateve për subjektet politike nga vendvotimet

1. Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, raportohen rezultatet e të gjitha subjekteve politike, në nivel vendi, komune, QV dhe VV.
2. Në zgjedhjet lokale, raportohen rezultatet e subjekteve politike për kuvende komunale dhe rezultatet e kandidatëve për kryetar të komunave. Të dhënat prezantohen në nivel komune, QV dhe VV.
3. Rezultatet e prezantuara përfshijnë:
 - 3.1. Numrin e votave të vlefshme për secilin subjekt politik;
 - 3.2. numrin e votave të vlefshme për secilin kandidat për kryetar komune;
 - 3.3. përqindjen e votave të fituara të secilit subjekt politik dhe/ose kandidat për kryetar komune, në raport me totalin e votave të vlefshme.

Neni 6

Paraqitja në platformën elektronike

1. Paraqitja në platformën elektronike bëhet në mënyrë jo diskriminuese për subjektet politike.
2. Paraqitja përfshin formën hartografike të komunave, ku pas klikimit në hapësirën e komunës prezantohen të dhënat e komunës përkatëse.
3. Për secilin subjekt politik vendoset një ngjyrë e caktuar, e cila e prezanton subjektin në paraqitjen grafike dhe duhet të ketë kontrast të mjaftueshëm, për të bërë dallimin e ngjyrave të subjekteve.
4. Në një vend të dukshëm paraqitet sqarimi se rezultatet preliminare nuk përfshijnë votat me kusht, votat jashtë Kosovës dhe votat e personave me nevoja të veçanta.

Neni 7

Verifikimi dhe kontrollimi i rezultateve nga KKZ

1. Pas publikimit të rezultateve dhe statistikave preliminare nga VV, KKZ bën kontrollimin e rezultateve të publikuara, duke i krahasuar me të dhënat që KKZ i proceson nga kopjet e FRS.
2. KQZ bën korrigjimin e rezultateve preliminare, sipas të dhënave për korrigjim të pranuar nga KKZ.

Neni 8

Publikimi i rezultateve preliminare nga QKN

1. Publikimi i rezultateve preliminare nga QKN përfshin:
 - 1.1. Rezultatet e përditësuara të subjekteve politike për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe kuvend komunal, pas verifikimit;
 - 1.2. rezultatet e përditësuara të kandidatëve për kryetar komune;
 - 1.3. rezultatet e kandidatëve të subjekteve politike.
2. Paraqitja e rezultateve bëhet sipas kritereve të nenit 6 të kësaj Rregullore.
 - 2.1. paraqitja e rezultateve të kandidatëve bëhet sipas renditjes në listën e kandidatëve.

Neni 9

Publikimi i rezultateve përfundimtare

1. Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilitdo VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.
2. Publikimi i rezultateve përfundimtare përfshin:
 - 2.1. Rezultatet e verifikuara nga QNR, pas përputhjes së të dhënave nga formularët e rezultateve dhe listës votuese, të pranuar nga QKN (për VV të rregullta);
 - 2.2. rezultatet e votave jashtë Kosovës dhe statistikat e listës votuese;
 - 2.3. rezultatet e votave me kusht dhe statistikat e listës votuese;
 - 2.4. rezultatet e votave të personave me nevoja të veçanta dhe statistikat e listës votuese.
3. Publikimi i rezultateve përfundimtare bëhet në mënyrë progresive nga QNR.
4. KQZ shpallë rezultatet përfundimtare, bazuar në nenin 106 dhe 111 të LZP, respektivisht nenit 8 të LZL.
5. Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e rezultatit.

Neni 10

Certifikimi i rezultateve përfundimtare

1. KQZ certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave nga PZAP dhe nga Gjykata Supreme.
2. Në bazë të rezultateve të certifikuara, KQZ përgatitë listën e të gjitha mandateve për zgjedhjet e certifikuara dhe ia paraqet Presidentit të Kosovës dhe institucioneve përkatëse.
3. Publikimi i rezultateve të certifikuara bëhet në formë tabelore dhe grafike dhe publikohen në ueb faqen e KQZ, ku përfshihen:
 - 3.1. Numri i votuesve të regjistruar;
 - 3.2. numri dhe gjinia e votuesve të cilët kanë votuar në secilin VV, QV dhe komunë;
 - 3.3. numri dhe gjinia e votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendit;
 - 3.4. numri dhe gjinia e votuesve të cilët kanë votuar me kusht;
 - 3.5. numri dhe gjinia e votuesve përmes VPNV;
 - 3.6. numri i përgjithshëm dhe gjinia e votuesve që kanë votuar;
 - 3.7. numri i fletëvotimeve të vlefshme;
 - 3.8. numri i fletëvotimeve të papërdorura;
 - 3.9. numri i fletëvotimeve të përdorura;
 - 3.10. numri i fletëvotimeve të pavlefshme;
 - 3.11. numri i fletëvotimeve të dëmtuara;
 - 3.12. numri i votave për secilin subjekt politik;
 - 3.13. numri i votave të fituara për secilin kandidat individual;
 - 3.14. numri i ulëseve të fituara për secilin entitet;
 - 3.15. formula e ndarjes së mandateve së bashku me rezultatet;
 - 3.16. emrat e kandidatëve të zgjedhur.
4. Përrjashtimisht paragrafit 3 të këtij neni, KQZ publikon rezultatet e certifikuara në platformën elektronike. Rezultatet në platformë elektronike duhet të publikohen në atë mënyrë që të bëhet filtrimi dhe sortimi i të gjitha të dhënave të paraqitura.
5. Rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve nga KQZ, janë përfundimtare dhe detyruese.

Neni 12

Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja Nr.13/2023 Rezultatet Preliminare, e datës 09.03.2023.
2. Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është procedura për raportimin e rezultateve preliminare dhe përfundimtare.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radonij





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA, u skladu sa ovlaštenjima datih članom 63, članom 64 Zakona br.08/L-228 o opštim izborima u Republici Kosovo, kao i članom 23 Internog pravilnika br. 02/2024 o zapošljavanju osoblja na određeno vreme u CIK-u, na redovnoj sednici održanoj dana 12.03.2024, donosi:

ODLUKA

Odluka o usvajanju plana za angažovanje osoblja na određeno vreme za proces glasanja za ili protiv razrešenja predsednika opština u opštinama Leposavić, Zubin Potok, Zvečan i Severna Mitrovica

- I. Usvaja se Plan za angažovanje osoblja na određeno vreme za proces glasanja za ili protiv razrešenja predsednika opština u opštinama Leposavić, Zubin Potok, Zvečan i Severna Mitrovica, koji će se održati 21. aprila 2024. godine.
- II. Plan kao u tački I, sastavni je deo ove odluke.
- III. Obavezuje se Sekretarijat CIK-a za sprovođenje ove odluke.
- IV. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Priština, 12.03.2024

Predsedavajući

Centralna izborna komisija


Kreshnik Radoniq





Plani i angazhimit të personelit të perkohshem për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut

Duke u bazuar në kërkesat e njësive kërkuese për angazhimin e personelit të perkohshem për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut si dhe duke u bazuar në miratimin e planit të buxhetit nga KQZ, Divizioni i Burimeve Njerëzore ditëve në vijim do të publikoj konkursin publik, konform Rregullores Nr. 02/2024, për pranimin e personelit të perkohshëm në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Pozitat e personelit të perkohshëm që do të angazhohen për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut, është :

Zyrtar të Personelit

Zyrtar të Përkthimit

Zyrtar për Buxhet dhe Financa

Zyrtar për monitorim të Informimit

Zyrtar të Trajnimit

Asistent për KQZ

Zyrtar Menaxhues i QNR

Zyrtar I tavolinës ndihmese në QNR

Zyrtar i logjistikes dhe Administrimit të Objektivit në QNR

Mirëmbajtës në QNR

Zyrtar i kordinimit në teren

Anëtar të KKZ

Zyrtar i Administrates dhe Logjistikes ne KKZ

Trajner për votim dhe numrim

Kryesues i Vendvotimit

Anëtarët e Vendvotimit

Anëtarët rezervë të vendvotimit

Zyrtar i Tavalinës Ndihmëse

Menaxher të Qendres së Votimit

Punëtor Fizik

Shërbime të Transportit .

Të gjitha të dhënat për angazhimin e personelit të përkohshëm për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat: Lepasaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut janë të specifikuara në formë tabelare, e cila i bashkëngjitet kësaj shkrese.

Numri total i gjithë të angazhuarve sipas planifikimit dhe planit buxhetor, është 705.

Plan i buxhetit për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat: Leposaviç, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut

Nr. R.	Pozita	Koeficienti	Vlera e Kd	Numri	Muajt	Totali
1	Zyrtar te Personelit	4.2	110	1	2	924.00
2	Zyrtar te Përkthimit	4.2	110	2	2	1,848.00
3	Zyrtar per Buxhet dhe Financa	4.2	110	1	1	462.00
4	Zyrtar per monitorim te Informimit	4.2	110	1	1	462.00
5	Zyrtar te Trajnimit	4.2	110	2	1	924.00
6	Asistent per KQZ	3.98	110	1	3	1,313.40
7	Zyrtar Menaxhues i QNR	4.2	110	1	1	462.00
8	Zyrtar i Tavolines ndihmese ne QNR	4.2	110	1	1	462.00
9	Zyrtar i Logjistikes dhe Administrimit te Objekteve ne QNR	4.2	110	1	1	462.00
10	Mirrembajtjes ne QNR	4.2	110	1	1	462.00
11	Zyrtar i kordinimit ne teren	4.2	110	1	1	462.00
12						
Kontributet Pensionale te Pu						13
Total						8,655.57

Nr. R.	Pozita	Koef/Paga	Vlera e Kd	Numri	Muajt	Totali
31	Anetar te KKZ	550		24	2	26,400.00
32	Zyrtar i Administrates dhe Logjistikes ne KKZ	3.98	110	4	1	1,751.20
33	Trajner per votim dhe numrim	4.2	110	8	1	3,696.00
34						
Kontributet Pensionale te Pu						36
Total						33,439.56

Nr. R.	Pozita	Rundi	Medija	Numri	Ditet	Totali
41	Kryesues i Vendvotimit	1	60	89	3	16,020.00
42	Anetaret e Vendvotimit	1	50	425	3	63,750.00
43	Anetar Rezervë te Vendvotimit	1	45	35	2	3,150.00
44	Zyrtar i Tavolines Ndihmëse	1	50	88	1	4,400.00
45	Menaxher te Qendres se Votimit	1	60	44	1	2,640.00
47	Punëtor Fizik	1	30	4	2	240.00
48	Sherbimet e transportit	1	60	20	2	2,400.00
49						
Kontributet Pensionale te Pu						705
Total						97,230.00
Totali i pergjithshem						139,325.13



CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA, u skladu sa ovlaštenjima datih članom 63, članom 64 Zakona br.08/L-228 o opštim izborima u Republici Kosovo, kao i članom 12, 13, 14 i 16 Internog pravilnika br. 10/2024 za dodatke i naknade u CIK-u, na redovnoj sednici održanoj dana 12.03.2024, donosi:

ODLUKA

Za odobrenje prekovremenog rada i povećanog obima posla za zaposlene u CIK-u

- I. Odobrava se prekovremeni rad i povećani obim posla za zaposlene u CIK-u za proces glasanja za ili protiv razrešenja predsednika opština u opštinama Leposavić, Zubin Potok, Zvečan i Severna Mitrovica, koji će se održati 21. aprila 2024. godine.
- II. Naknada za rad van redovnog radnog vremena, rad tokom službenih praznika i vikendom, obračunava se za svaki radni sat, dodajući vrednost na sledeći način:
 1. Trideset posto (30%) po satu, za prekovremeni rad tokom radnih dana;
 2. Pedeset posto (50%) po satu, za rad tokom vikenda;
 3. Pedeset posto (50%) po satu, za prekovremeni rad tokom službenih praznika.
- III. Povećanje obima posla odobrava se zaključenjem sporazuma Direktora Sekretarijata CIK-a sa civilnim službenikom, da radi sa povećanim obimom. Vrednost dodatka za obim posla iznosi do dvadeset odsto (20%) osnovne plate državnog službenika i odnosiće se na ISOIK koji će biti raspoređeni da obavljaju dodatni rad u opštinama Leposavić, Zubin Potok, Zvečan i Severna Mitrovica.
- IV. Obavezuju se Sekretarijat CIK-a i Kancelarija da sprovode ovu odluku, u skladu sa Internim pravilnikom br. 10/2024 o dodacima i naknadama u CIK-u.
- V. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Obrazloženje

Na osnovu Odluke CIK-a od 08.03.2024. godine, br. 01/206/2024, o usvajanju izveštaja o verifikaciji peticije i preporuke za određivanje datuma za glasanje za ili protiv razrešenja predsednika opština u opštinama Leposavić, Zubin Potok, Zvečan i Severna Mitrovica, neophodna potreba za prekovremenim radom i povećanje obima posla za zaposlene u CIK-u, u cilju organizovanja ovog procesa, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

Priština, 12.03.2024

Predsedavajući

Centralna izborna komisija

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Kreshnik Radoniqi', written over a horizontal line.

Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA, u skladu sa ovlašćenjima datih članom 63, članom 64, članom 113 Zakona br.08/L-228 o opštim izborima u Republici Kosovo, na redovnoj sednici održanoj dana 12.03.2024, donosi:

ODLUKA

O odobrenju zahteva za dodatni budžet za proces glasanja za ili protiv razrešenja predsednika opština u opštinama Leposavić, Zubin Potok, Zvečan i Severna Mitrovica

- I. Odobrava se zahtev za dodatni budžet za proces glasanja za ili protiv razrešenja predsednika opština u opštinama Leposavić, Zubin Potok, Zvečan i Severna Mitrovica, koji će se održati 21. aprila 2024. godine.
- II. Dodatni budžet u iznosu od 15.000,00 evra koji će biti iskorišćen za nabavku IT opreme za transparentnost rada CIK-a.
- III. Dodatni budžeti u iznosu od 2.000,00 evra, za uslove rada i uslove za osoblje CIK-a, u vezi sa procesom glasanja iz tačke I ove odluke.
- IV. Obavezuje se Sekretarijat CIK-a za sprovođenje ove odluke.
- V. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Priština, 12.03.2024

Predsedavajući

Centralna izborna komisija



Kreshnik Radoniqi